REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 97, datë 25. 06. 2014

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR INFORMACIONIN KRYESOR QË DUHET T'I VIHET NË DISPOZICION INVESTITORIT TË SKEMAVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", nenit 85, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Për informacionin kryesor që duhet t'i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive", sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

DRAFT

RREGULLORE
PËR
INFORMACIONIN KRYESOR QË DUHET T'I VIHET NË DIPOZICION INVESTITORIT TË SKEMAVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për dhënien e detyrueshme të informacionit kryesor për investitorin nga shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, për përmbajtjen e detajuar të informacionit kryesor dhe për kushtet që duhen plotësuar kur ky informacion jepet në formën e *durable medium*.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 85 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Neni 3
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a. **informacioni kryesor për investitorin** – nënkupton dokumentin, i cili në formë të përmbledhur përmban informacionin e përshtatshëm rreth karakteristikave thelbësore të sipërmarrjes së investimeve kolektive, dhe që ndihmon investitorin të kuptojë natyrën dhe risqet e investimit që po i ofrohet, në mënyrë që vendimin për investim ta marre duke qenë i informuar mirë.

b. ***durable medium*** – nënkupton çdo instrument, i cili ndihmon investitorin të gjejë informacionin që i adresohet atij personalisht në një mënyrë të aksesueshme në një kohë

të përshtatshme dhe që nuk lejon riprodhim të ndryshueshëm të informacionit të rezervuar.

c. **ndryshim me efekt material** – nënkupton ndryshimet thelbësore të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 76 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

d. **SIK** – nënkupton Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive sipas përcaktimit të dhënë në nenin 2 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

e. **Autoritet** – nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 4
Fusha e zbatimit

Kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore do të zbatohen nga çdo shoqëri administruese në lidhje me çdo SIK që ajo ka nën administrim.

Neni 5
Karakteristikat thelbësore të informacionit kryesor për investitorin

1. Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë i paanshëm, i qartë dhe jo çorientues.

2. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin duhet të jepet në mënyrë të tillë që investitori të jetë në gjendje ta dallojë atë nga materialet e tjera për SIK. Veçanërisht, informacioni nuk duhet të paraqitet ose të shpërndahet në mënyrë të tillë që investitorët ta konsiderojnë atë si më pak të rëndësishëm se informacionet e tjera rreth SIK dhe risqeve e përfitimeve të saj.

3. Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë në përputhje me pjesët përkatëse të prospektit.

4. Informacioni kryesor i jepet investitorit pa pagesë**.**

Neni 6
Koha e vënies në dispozicion të informacionit kryesor

1. Shoqëria administruese përpara nënshkrimit të kuotave/aksioneve të SIK, i jep investitorit informacionin kryesor për çdo SIK që ka nën administrim.

2. Në rastin e shitjes së kuotave/aksioneve të SIK nëpërmjet një agjenti, ky i fundit detyrohet t'i japë investitorit informacionin kryesor përpara nënshkrimit të kuotave/aksioneve të SIK.

Neni 7
Prezantimi dhe gjuha e dokumentit me informacionin kryesor

1. Dokumenti me informacionin kryesor mbi investitorin duhet të jetë:

a. I paraqitur dhe i parashtruar në një mënyrë të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur shkronja të një madhësie të lexueshme.
b. I shprehur qartë dhe i shkruar me një gjuhë që i krijon lehtësi investitorit të kuptojë informacionin të cilin po i komunikohet, veçanërisht gjuha e përdorur:
   i. duhet të jetë e qartë, e përmbledhur dhe e kuptueshme;
   ii. duhet të shmangë përdorimin e fjalëve të huaja dhe të pakuptueshme për publikun, si dhe dialektalizmat;
   iii. duhet të përmbajë, aty ku mundet, fjalë të përditëshme dhe duhet të shmangë termat teknike.
c. I fokusuar tek informacioni kryesor për të cilin ka nevojë investitori.

2. Në rastin kur dokumenti origjinal me informacionin kryesor është i përgatitur me ngjyra, printimi apo fotokopjimi në bardh e zi nuk duhet të ndikojë në zvogëlimin e shkallës së të kuptuarit të informacionit.

3. Përdorimi i logos të shoqërisë administruese, apo grupit të cilit ajo i përket, duhet të bëhet në mënyrën të tillë, që të mos tërheqë vëmendjen e investitorit, apo të lërë në hije tekstin e dokumentit.

4. Dokumenti i printuar me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të kalojë dy faqe të formatit A-4.

Neni 8
Elementet që duhet të përmbajë informacioni kryesor

1. Informacioni kryesor për investitorin duhet ta japë informacionin mbi SIK, mbështetur në elementet e mëposhtme:
a. Pjesa hyrëse dhe identifikimi i SIK;
b. Një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit;
c. Profili i riskut dhe i përfitimit nga investimi, duke përfshirë udhëzues të duhur dhe paralajmërime në lidhje me risqet që shoqërojnë investimin në SIK përkatëse;
d. Kostot dhe pagesat;
e. Paraqitja e ecurisë dhe rezultateve në të kaluarën, kur është e përshtatshme, si dhe skenarë të rezultateve në të ardhmen;
f. Informacion tjetër praktik.

2. Këto elemente thelbësorë duhet të jenë të kuptueshme për investitorin, dhe duhet sqarohen qartë, pa qenë nevoja të jepen referenca në dokumenta të tjerë.

3. Formati i standardizuar i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin paraqitet në aneksin bashkangjitur kësaj rregulloreje.

Neni 9
Pjesa hyrëse e dokumentit dhe identifikimi i SIK

1. Titulli i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin vendoset në krye të faqes së parë, duke përdorur shprehjen: "*Informacion kryesor për investitorin*".

2. Poshtë titullit jepet një deklaratë, ku thuhet: "*Ky dokument ju paraqet informacionin kryesor për investitorin në lidhje me këtë SIK. Ai nuk është material marketingu. Ky informacion kërkohet nga rregullorja nr. _____ datë _____. për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet e SIK. Përpara se të merrni vendim për të investuar ju këshillojmë ta lexoni me vëmendje këtë informacion*".

3. Poshtë deklaratës jepen të dhëna identifikuese mbi SIK, duke përfshirë të paktën llojin e SIK (fond apo shoqëri investimi), emërtimin e SIK, llojin e SIK duke u nisur nga politika e investimit, emrin e shoqërisë administruese. Në rastet kur shoqëria administruese bën pjesë në një grup shoqërish për qëllime ligjore, administrative ose marketingu, atëherë mund të jepet edhe emërtimi i grupit. Emërtimi i grupit mund të jepet nëse nuk krijon pengesë për investitorin që të kuptojë elementet kryesore të investimit dhe pakëson mundësinë e tij për të krahasuar produktet e investimit.

4. Në pjesën hyrëse të dokumentit duhet të përfshihet edhe një deklaratë ku të theksohet se kuotat/aksionet e SIK nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, se investimi ne SIK nuk është një investim i garantuar, se SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe se rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Neni 10
Përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar "*Objektivat dhe politika e investimit*" përbën një nga seksionet e rëndësishme për informimin e investitorit. Ky seksion është i detyrueshëm për t'u përfshirë në dokument, edhe në rastet kur përshkrimi i objektivave dhe politikës së investimit nuk është paraqitur në prospekt. Ky seksion duhet të përmbajë:

a. Kategoritë kryesore të instumentave financiarë që janë objekt i investimit;

b. Deklaratën që investitori mund të shlyejë/shesë kuota/aksione të SIK sipas kërkesës së tij/saj, dhe sa shpesh mund ta bëjë këtë;

c. Një objektiv të caktuar të SIK (nëse ka) në lidhje me sektorët e industrisë, terrenin gjeografik apo sektorë të tjerë të tregut ose klasa specifike të aseteve;

d. Deklaratën nëse SIK lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme, dhe nëse SIK i referohet një benchmark-u dhe cili është ky;

e. Deklaratën nëse të ardhurat nga SIK shpërndahen apo ri-investohen;

f. Informacion tjetër, që vlerësohet se është i përshtatshëm, si:

   i. Kur SIK investon në letrat me vlerë të borxhit, duhet të tregohet nëse ato janë emetuar nga shoqëritë, qeveritë apo subjekte të tjera;

   ii. Informacion në lidhje me ndonjë pagesë të paracaktuar dhe faktorët që parashikohet të ndikojnë në performancën e SIK;

   iii. Nëse zgjedhja e aseteve udhëhiqet nga rritja, tregohet vlera e dividentëve ose dividentët më të lartë;

   iv. Si mund të ndikojnë në performancën e fondit përdorimi i teknikave, të tilla si: mbrojtja (*hedge*), arbitrimi (*arbitrage*) apo shkalla e huamarrjes (*leverage*);

   v. Nëse kostot e transaksioneve të protofolit do të kenë një ndikim material mbi performancën;

   vi. Afati minimal i rekomanduar për investimin në SIK.

2. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar "*Objektivat dhe politika e investimit*" mund të përmbajë edhe elemente të tjerë përveç atyre të përmendur në paragrafin 1, duke përfshirë këtu përshkrimin e strategjisë së investimit të SIK.

Neni 11
Profili i riskut dhe përfitimi nga investimi

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar "*Profili i riskut dhe përfitimit*", duhet të përmbajë:

a. Një tregues sintetik mbi riskun të paraqitur në mënyrë grafike, ku risku më i ulët shënohet me nr. 1 dhe risku më i lartë me nr. 7;
b. Një shpjegim me fjalë të treguesit dhe kufizimeve të tij kryesore, i cili duhet të përfshijë informacionin si më poshtë:
   i. Një deklaratë se të dhënat historike, të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik, mund të mos jenë të dhëna të besueshme për profilin e ardhshëm të riskut të SIK;

   ii. Një deklaratë se kategoria e treguar e riskut dhe e përfitimit nuk garantohet se do të mbetet e pandryshuar,dhe se kategoria e riskut me kalimin e kohës mund të ndryshojë;

   iii. Një deklaratë se kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk;

   iv. Një shpjegim i shkurtër se përse SIK është në kategorinë përkatëse;

   v. Detaje për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje të ofruar nga SIK për kapitalin e investitorit, duke pëfshirë këtu efektet e mundshme për shlyerjen e kuotave jashtë periudhës së garantuar ose të mbrojtur;

c. Një shpjegim me fjalë të risqeve materialisht të lidhur me SIK dhe që nuk paraqiten mjaftueshëm nga treguesi sintetik, siç janë:

   i. Risku i kreditit, kjo në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në titujt e borxhit;

   ii. Risku i likuiditetit, kjo në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në instrumenta financiarë, të cilat prej natyrës, në rrethana të caktuara, mund të kenë një nivel të ulët likuiditeti, aq sa mund të kenë një ndikim mbi nivelin e riskut të likuiditetit të SIK në tërësi;

   iii. Risku i palës tjetër, kur SIK garantohet nëpërmjet garancisë së një pale të tretë, ose kur ka ekspozim material si rezultat i kontratave me një palë tjetër;

   iv. Risku operacional që rezulton nga ruajtja e aseteve;

   v. Ndikimi i teknikave financiare, siç mund të jenë kontratat derivative, kur këto teknika përdoren për të arritur, rritur apo zvogëluar ekspozimin e aseteve.

Neni 12
Pagesat për llogari të SIK

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar "*Pagesat e SIK*" duhet të përmbajë fillimisht një deklaratë rreth rëndësisë së pagesave, të cilat përdoren për të paguar kostot e administrimit të SIK, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave/aksioneve të SIK. Deklarata duhet të cilësojë se pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

2. Pagesat në seksionin "*Pagesat e SIK*" paraqiten në formën e një tabele, ku përfshihen:

a. Pagesat e hyrjes dhe daljes nga SIK. Këto pagesa shprehen në përqindjen maksimale të tyre, që nënkuptojnë shumën maksimale që duhet të paguhet nga investitori për llogari të SIK para investimit, dhe shumën maksimale para daljes nga SIK;

b. Pagesat vjetore, që paraqiten në një shifër të vetme dhe që njihen si detyrime në vazhdim;

c. Tabela duhet të listojë dhe shpjegojë edhe çdo pagesë tjetër sipas kushteve specifike të SIK, bazën mbi të cilën llogaritet dhe aplikohet ky detyrim.

3. Për secilën nga pagesat e specifikuara në tabelë duhet të jepet një shpjegim me fjalë, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

a. Në lidhje me "pagesat e hyrjes dhe daljes" duhet të bëhet e qartë se shifrat e paraqitura janë shifra maksimale, pasi në disa raste investitori mund të paguajë më pak, për këtë fakt investitori mund të informohet nga këshilltari i tij i investimit;

b. Në lidhje me “pagesat vjetore apo në vazhdim”, duhet të bëhet një deklaratë se shifra e kësaj pagese bazohet në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Pagesa vjetore përfshin:

   i. tarifën e performancës;

   ii. kostot e transaksioneve të portofolit, duke përjashtuar rastin e pagesave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK të tjera.

4. Seksioni për pagesat duhet të bëjë referencën me ato pjesë të prospektit të SIK ku jepet informacioni më i detajuar rreth pagesave.

Neni 13
Paraqitja e performancës së kaluar

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “*Paraqitja e performancës së kaluar*” jep informacion rreth performancës së SIK për periudhat e mëparshme, duke e paraqitur në një grafik dhe duke treguar performancën e SIK (normën e kthimit) për 10 vitet e fundit.

2. Paraqitja grafike e sipërpërmendur duhet të jetë e lexueshme, por në asnjë rrethanë nuk duhet të jetë më shumë se gjysmë faqe e formatit A-4, të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin.

3. SIK me një aktivitet më pak se pesë vite të plota kalendarike duhet të përdorë një prezantim ku paraqiten vetëm pesë vitet e fundit. Për çdo vit për të cilin nuk ka të dhëna, ai duhet të paraqitet bosh dhe nuk bëhet asnjë shënim tjetër përveç datës. SIK, për të cilën ende nuk ka të dhëna mbi performancën për një vit të plotë kalendarik, duhet të paraqesë një deklaratë ku shpjegohet se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të siguruar një tregues të dobishëm për performancën e kaluar të investitorit.

4. Grafiku duhet të shoqërohet nga deklarata, ku të shfaqen dukshëm:

a. Paralajmërimi për vlerën e kufizuar që ai ka si udhërrëfyes për performancën e ardhshme;

b. Paraqitja shkurtimisht e pagesave, cilat janë përfshirë apo përjashtuar në përllogaritjen e përformancës së kaluar;

c. Paraqitja e vitit, kur SIK filloi të emetojë kuota/aksione;

d. Paraqitja e monedhës në të cilën është përllogaritur performanca e kaluar.

5. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë të vitit aktual kalendarik, duke e konsideruar si përformancë e kaluar.

6. Përllogaritja e shifrave të performancës së kaluar duhet të bazohet në vlerën neto të aseteve të SIK, dhe duhet të mbahet parasysh nëse të ardhurat nga investimi i aseteve të SIK janë ri-investuar.

7. Në rastin e një ndryshimi në objektivat dhe politikën e investimit me efekt material gjatë periudhës së paraqitur në grafik, performanca e kaluar e SIK vazhdon të pasqyrohet para këtij ndryshimi material. Periudha para ndryshimit me efekt material duhet të tregohet në grafik dhe të etiketohet me një paralajmërim të qartë se kjo performancë është arritur në rrethana që nuk aplikohen më.

Neni 14
Informacioni praktik

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar "*Informacion praktik*" përmban informacionin si më poshtë:

a. Emrin e depozitarit;
b. Ku dhe si do të sigurohet informacioni i mëtejshëm rreth SIK (prospekt, raportet dhe llogaritë);
c. Ku dhe si do të sigurohet informacioni praktik (p.sh. cmimet me të fundit të kuotave/aksioneve);
d. Një deklaratë që legjislacioni tatimor mund të ketë një ndikim në tatimin personal të investitorit - shtetas i huaj;
e. Një deklaratë me këtë përmbajtje *"Shoqëria administruese mund të konsiderohet përgjegjëse e vetme për çdo keqkuptim, pasaktësi ose parregullsi që gjendet në këtë dokument, në ndryshim nga pjesët përkatëse të prospektit të SIK."*

Neni 15
Seksioni përmbyllës i dokumentit

1. Në seksionin përmbyllës të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin përfshihen detajet e licencës së shoqërisë administruese dhe të SIK.

2. Dokumenti mbyllet me deklaratën: *"Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit"*.

Neni 16
Rishikimi i informacionit kryesor për investitorin

1. Shoqëria administruese duhet të bëjë një rishikim të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin të paktën çdo dymbëdhjetë muaj.
2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, rishikimi i dokumentit duhet të bëhet përpara çdo ndryshimi të propozuar të prospektit dhe të rregullave të SIK.
3. Rishikimi duhet të kryhet përpara ose gjatë çdo ndryshimi që konsiderohet me efekt material për informacionin që përmban dokumenti me informacionin kryesor për investitorin.

Neni 17
Publikimi i dokumentit të rishikuar

1. Dokumenti i rishikuar, sipas pikës 1 të nenit 16 të kësaj rregulloreje, duhet të vihet menjëherë në dispozicion të investitorit.
2. Dokumenti i rishikuar, sipas pikës 2 të nenit 16 të kësaj rregulloreje, duhet të vihet në dispozicion të investitorit përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi.
3. Dokumenti i rishikuar si rezultat i korrigjimit të seksionit mbi performancën e kaluar të SIK, duhet të vihet në dispozicion të investitorit jo më vonë se 35 ditë pune pas datës 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 18
Mënyrat e dhënies të informacionit kryesor për investitorin

1. Shoqëria administruese dhe çdo SIK nën administrimin e saj jep informacion kryesor për investitorin duke e publikuar në formë letre, elektronike në *website*, ose *durable medium*. Kopja në letër i dërgohet investitorit sipas kërkesës dhe pa pagesë.

2. Dokumenti i rishikuar me informacionin kryesor për investitorin duhet të jetë i publikuar në *website*-in e shoqërisë administruese.

Neni 19
Kushtet për dhënien e informacionit nëpërmjet *durable medium*

1. Informacioni kryesor për investitorin jepet nëpërmjet *durable medium*, kur plotësohen kushtet si më poshtë:
   a. Marrëdhënia e biznesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe
   b. Investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *durable medium*.

2. Kur dokumenti mbi informacionin kryesor për investitorin do të jepet nëpërmjet *website*-it dhe ky informacion nuk do të adresohet personalisht tek investitori, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
   a. Marrëdhënia e bisnesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe
   b. Investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *website*-it;
   c. Investitori duhet të njoftohet në mënyrë elektronike për adresën e *website*-it dhe vendin e *website*-it, ku informacioni është i aksesueshëm;
   d. Informacioni duhet të jetë i përditësuar;
   e. Informacioni në këtë *website* duhet të jetë i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme përsa kohë investitori mund të ketë nevojë për ta kontrolluar.

Neni 20
Dërgimi në Autoritet

1. Shoqëria administruese për çdo SIK nën administrim duhet të dërgojë në Autoritet një kopje të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, si dhe çdo amendim të këtij dokumenti.

2. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin duhet të japë informacionin më të fundit.

Neni 21
Shkeljet

Në rast mosrespektimi të kërkesave të parashikuara në këtë rregullore shoqëria administruese do të jetë subjekt i masave të parashikuara në nenin 130 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 22
Dispozitë kalimtare

Shoqëria administruese për SIK që ka nën administrim para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, detyrohet të hartojë dhe dërgojë për miratim dokumentin me informacionin kryesor të investitorit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në 1 shtator 2014